



Pranuar / Dorezuar Priljezja / Prodati Received / Delivered	25	11	2022	2	viti god year
Organ / Rrjesia Organ / Rrjesia Org. Unit	Nr. Prot It. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKRIMSHKIC 7421/2022			114		



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.506/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1890/2021 të datës 26.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 2912/2021 të datës 07.06.2021 të parashtruar nga ankuesi

me adresë banimi kundër organit të punësimit- Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.11.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**I. DETYROHET** Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të nxjerrë akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me kërkesën e ankuesit me numër protokollit 2021/DSF/180,të datës 04.06.2021.

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesi i caktuar në pozitën Zyrtarë i operimeve për Helikopter në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve sipas akt emërimit të datës 01.01.2013 i nënshkruar me datën 31.12.2012, më datën 04.06.2021 ka bërë kërkesë me numër protokollit 2021/DSF/180, për Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës pasi që ka përmbushë kërkesën e Manualit të Trajnimeve dhe Kredencialet për inspektor ndërsa i janë dhënë me 19.12.2018 nga ana e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm.

Ankuesi pas marrjes së përgjigjes të datës 07.06.2021 me numër protokoll 2021/2DP/181 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës lidhur me kërkesën e datës 04.06.2021, ka parashtruar ankesë me datën 07.06.2021 me numër protokoll 2912/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.06.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës. Me datën 16.06.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 21.07.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, pasi ka pranuar Njoftimin e datës 21.07.2021 me numër protokoll 3825/2021, ka parashtruar kërkesë padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, duke iniciuar konflikt administrativ, e cila me datë 26.10.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1890/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 21.07.2021 për ankesën me numër A.nr.596/2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 07.06.2021 me numër protokoll 2912/2021.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 2912/2021 të datës 07.06.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për çështjen e delegimit të detyrave dhe përgjegjësive të Inspektorit në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve e datës 22.03.2021 për Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Delegimi i Inspektorit -Inspektor i Operimeve për Helikopter e datës 19.12.2018; Njoftim i datës 31.03.2021; Kërkesë e datës 04.06.2021 për çështjen e delegimit të detyrave dhe përgjegjësive të Inspektorit në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve; Përgjigje e datës 07.06.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil; Akt emërimi i datës 31.12.2012; ID kartela kredencialet e inspektorit 01/02/2020 -21.01.2022; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 19.12.2018; Çertifikatë e vitit 2013; Çertifikatë e muajit shkurt 2014; Çertifikatë e muajit tetor 2014; Çertifikatë e muajit janar 2015; Çertifikatë e muajit qershor 2017; Çertifikatë e muajit maj 2018; Vazhdimi i kartelës të kredencialeve të Inspektorit; Formular vlerësimi për inspektor i datës 24.01.2020' Lista e trajnimeve 22.11.2019 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 15.06.2021 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/36; Prova shtesë të datës 16.11.2022 me numër protokoll 7160/2022 faqe 1/80 të ofruara nga përfaqësuesi i autorizuar; Raporti i punës për periudhë javore 14.10.2022; Raporti i punës për periudhë javore 27.15.2022; Raporti i punës për periudhë javore 13.16.2022; Raporti i punës për periudhë javore 10.06.2022; Çertifikatë e datës 01-03.2022; Miratimi i Përgjithshëm i Fluturimit të trafikut Ajror nr.129-2022; Vendimi i datës 17.09.2021 me numër ref.28/2021 i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil;

Trajnim i datës 01.01.2013-01.02.2015; Vendimi i datës 08.11.2021 me nr.ref.32/2021; E-mail zyrtar i datës 01.08.2022; E-mail zyrtar i datës 11.05.2021; E-mail zyrtar i datës 29.08.2021; E-mail zyrtar i datës 26.04.2022; E-mail zyrtar i datës 22.04.2022; E-mail zyrtar i datës 01.10.2021; E-mail zyrtar i datës 12.07.2022; E-mail zyrtar i datës 13.06.2022; E-mail zyrtar i datës 04.03.2022; E-mail zyrtar i datës 13.05.2022; E-mail zyrtar i datës 23.07.2021; E-mail zyrtar i datës 18.05.2022; E-mail zyrtar i datës 13.05.2022; E-mail zyrtar i datës 08.08.2022; E-mail zyrtar i datës 05.08.2022; E-mail zyrtar i datës 03.08.2022; E-mail zyrtar i datës 27.09.2021; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 18.01.2021; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 04.12.2019; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 18.12.2017; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 12.12.2015; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 28.12.2016; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 16.12.2014; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil i datës 20.12.2018; Raporti i vlerësimit të rezultateve nga data 01.01.2013-31.12.2013 Kërkesë e datës 04.06.2021 për Drejtorin e Përgjithshëm të AAC-së; kopja e licencës ; Çertifikatë e datës 18.01.1986; Çertifikatë e datës 15-18. 05.2018; Çertifikatë e datës 20-24.10.2014; Çertifikatë e datës 20-21.06.2017 Çertifikatë e datës 18.11.2019; Çertifikatë e datës 30.04.2021 dhe Çertifikatë e datës 05.04.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të nxjerr akt administrativ, *sepse*:

Gjatë shqyrtimit të provave të lëndës si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së Përgjigja e datës 07.06.2022 me nr.2021/2DP/181 e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është kundërtënëse me vet përmbajtjen e saj dhe se me të njëjtën nuk është trajtuar kërkesa e ankuesit e datës 04.06.2021 ashtu siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, rrjedhimisht Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës nuk ka nxjerr akt administrativ me të cilin përveç që palës do t'i epet mundësia të kontestoj një akt administrativ, po ashtu do të sigurohej mundësia e palës që ta kuptojë aktin administrativ, sepse në bazë të përgjigjes së datës 07.06.2022 pala nuk ka arritur të marr përgjigje konkrete konformë kërkesës së parashtruar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Ankuesi me datën 04.06.2021 ka parashtruar kërkesë për Drejtorin e Përgjithshëm të Aviacionit Civil, me arsyetimin se kredencialet për inspektor, ankuesit i janë dhënë me datë 19.12.2018 nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës edhe pse që nga ajo kohë ankuesi kryen detyrat dhe përgjegjësit e Inspektorit për operime me helikopter, por deri më tani nuk ka reflektuar as në ndryshimin e akt emërimit e as në rritjen e pagës. Në kërkesën e datës 04.06.2021 ankuesi nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka kërkuar që t'i bëhet ndryshimi i akt emërimit nga zyrtarë për operime për helikopter në inspektor për operime për helikopter në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve sipas kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të përshkruara në "Inspektor's

Delegation" dhe të rimbursohet për ndryshimin/diferencen në pagë që nga muaji dhjetor 2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke pasur parasysh faktin se ankuesi ka bërë disa kërkesa në adresë të zyrtarëve kompetentë të institucionit përkatës që të rregullojë këtë çështje që lidhet me këtë ankesë, por se nga shkresat e lëndës dhe përgjigja nga institucioni kompetentë në lidhje me këtë ankesë nuk kemi hasur në ndonjë veprim konkretë administrativë që merrë në shqyrtim këtë kërkesë konkrete me qëllim që të nxjerrin akt administrativë në lidhje me këtë kërkesë, andaj mbi këtë bazë të potencuar më lartë obligon Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil që të shqyrtojë kërkesën e ankuesit dhe me rastin e shqyrtimit të kërkesës së ankuesit të datës 04.06.2021, të veprojë konformë legjislacionit në fuqi që rregullonë këtë çështje duke nxjerrë një aktë administrativë sipas kësaj kërkesë konformë dispozitave ligjore në fuqi, nga se kolegji vlerëson se është obligim i organit kompetentë të punësimit që të përgjigjet konformë dispozitave të LPPA-së (Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative) ndajë çdo kërkesë që adresohet përmes procedurave administrative.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin nga Kryetari i Kolegjit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda: A.nr.506/2020, datë 25/11/2022

Sabile Avdyli  
  
Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet;**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.